



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 24 datë 27.03. 2024

“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCES NË BASHKINË VAU DEJËS”

Këshilli i Bashkisë Vau Dejës i mbledhur me datë 27/03 2024, në mbështetje të nenit 9, 15, 18/3, 55, të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, në nenin 4 dhe 5 të ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në Urdhërin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjes së të Dhënave Përsonale, Nr.211, datë 10.09.2018, “Per Miratimi e Programit Model të Transparencës në Njesitë e Qeverisjes Vendore”, Këshilli i Bashkisë Vau Dejës, pasi shqyrtoj projekt-vendimin e paraqitur për miratim nga “Drejtoria e Informimit Publik, Medias, Statistikes dhe TIK”, me shumicë të votave:

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I:

- 1.Miratimin e “Programit të Transparencës” në Bashkinë Vau Dejës, të njësive dhe strukturave administrative në varësi të saj, sipas tabelave përmbledhese bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2.Brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ky program të publikohet në faqen zyrtare të internetit të bashkisë në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”, si dhe në vendet e caktuara për njoftimet publike të bashkisë dhe njësive administrative.
- 3.Për zbatimin e “Programit të Transparencës”, ngarkohet Kryetari Bashkisë Vau Dejës, Drejtoria e Informimit Publik, Medias, Statistikes dhe TIK, Kordinatori i Transparencës, si dhe të gjitha strukturat administrative dhe organizative në varësi të Bashkisë Vau Dejës.
- 4.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të bera në piken 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLIT

Ervis Shimaj

SEKRETAR KËSHILLIT

Adrian Pelopaj

Miratuar me 17 vota

Vota Pro 17

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 02.04.2024